



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.53/2016

Prishtinë, më 19.04.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa -kryetar, Sasha Milosavljeviq, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Besim Beqaj, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Besim Tafa, Remzije Hajdari dhe Besart Dreshaj-MTI; Fazlie Bekteshi, Skender Xani, Nezir Myrtaj dhe Dehiza Shabanaj-MZHE, Fjolla Uka – KDI; Dren Ajeti – GLPS; Florina Ujupi- BIRN, Përparim Bublaku- Lajmi Net, Kushtrim Ahmeti- KTV, Ardian Zullufi- Rrokum TV dhe Ismail Shabani- Kosova Press; Evlina Kabashi dhe Mjellma Kadriu– Praktikante të Komisionit.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.04.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-064 për Patentë shofer;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit Nr.05/L-081 për Energjinë;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.04.2016

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 12.04.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-064 për Patentë shofer

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, shqyrtimin e Projektligjit për Patentë shofer, tha se pas vendimit të Kuvendit nr.05-V-263, i datës 30.3.2016, për harmonizimin e amendamenteve më Komisionin e përhershme për Legjislacion, Komisioni ka autorizuar deputetin Raif Qela që nga grupi i punës të marrë pjesë në takimin e përbashkët më Komisionin e përhershëm për legjislacion, pas takimit të përbashkët që kanë pasur në Komision për Legjislacion më 15.04.2016. Aty janë pajtuar që t'i harmonizojnë amendamentet si vijon: Komisionin për legjislacion përkrahu propozimin në amendamentin 4 i riformuluar nga Komisioni Funkcional, kurse nuk e përkrahu formulimin aktual për amendamentin 17, më vërejtjet e njëjta, si në raportin e datës 11.3.2016, si dhe të shtohet edhe një amendament i ri sa i përket organit kompetent për lëshimin e patentë shoferit ndërkombëtar. Pastaj i propozoi amendamentet si vijon:

Amendamenti 4

Neni 3, nënparagrafi 1.3 ndryshohet si vijon:

1.3. Patentë shoferi ndërkombëtar (PSHN) - dokument i nxjerr sipas kërkesës së palës, i cili i mundëson mbajtësit të tij që ta drejtojë automjetin në ato shtete jashtë Kosovës, të cilat e kërkojnë këtë dokument plotësues, sipas Konventën e Vjenës për Trafikun Rrugor, të dt. 8.11.1968. Është një dokument plotësues, i përkthyer në shumë gjuhë, i cili i përshkruan të dhënat nga patentat e shoferit, i lëshuar nga institucioni kompetent i shtetit, që ka fotografi të drejtuesit të automjetit dhe të dhëna relevante mbi të drejtën për drejtim. Ky dokument nuk i lejon pronarit të tij që ta drejtojë automjetin në vendin e origjinës.

Amendamenti 17

Neni 6, paragrafi 5, pjesa e tekstit: “Për kundërvajtje, dënohet me gjobë” ndryshohet në “Dënohet për kundërvajtje, me gjobë” dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.”

Amendamenti 90

Neni 97, pas paragrafit 2 shtohet një paragraf i ri si vijon:

Patentë shoferin ndërkombëtar e lëshon Ministria e Punëve të Brendshme ose institucioni të cilin e autorizon kjo ministri.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit Nr. 05/L-064 për Patentë shofer;*
- 2. Raporti me Rekomandime t'i procedohet Kuvendit sipas porcedurave të rregullta.*

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se sa i përket Projektligjit për Investimet strategjike, Komisioni është konsultuar më të gjitha palët e interesuara siç është: Banka Botërore, Zyra e Bashkimit Evropën në Kosovë dhe me Shoqërinë Civile. Komisionin po ashtu ka organizuar dëgjimi publik, ku kanë qenë të ftuar të gjitha institucionet që kanë të bëjnë me sektorët e investimeve dhe që kanë interesuar. Ai theksoi se grupi i punës e ka shqyrtuar dhe analizuar mirë deri në detaje në një punëtori, ku kanë qenë të ftuar dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si hartues për të arsyetuar projektligjin në fjalë. Pastaj grupi i punës i ka hartuar 34 amendamente. Këto amendamente, që janë nxjerrë, e kanë qartësuar shumë projektligjin në aspektin e përkufizimeve, ku është dhënë një përkufizim më qartë se kush mund të jetë investitor strategjik, që ka kredibilitet dhe referenca të mira nga Bankat Ndërkombëtare. Andaj, amendamentet kanë bërë rritjen e transparencës, përsheptimin e procedurave për leje dhe licenca, gjithashtu lejohet konkurrenca e lirë dhe barabartë për gjithë investitorët dhe për çdo sektor veç e veç. Z. Mustafa, tha se një çështje që ende ka mbetur e hapur është të shpronësimi i pronave shoqërore për nevojat investimeve strategjike që do të e analizojmë dhe konsultohemi më përfaqësuesin e MTI-së.

Blerim Grainca tha se në parim jam për, që duhet të ketë Projektligj për Investime Strategjike, por i kam disa rezerva të kuota e caktuar. Për të qenë investitor strategjik, duke ditur trendin e investimeve, nuk mund t'i joshim më këto vlera të larta. Prandaj vlera e investimeve duhet të ulën dhe të forcohen kriteret dhe propozoi të rishikohen këto vlera.

Fatmir Rexhepi tha se është njëri për ligje më të rëndësishëm, prandaj duhet të analizohet më kujdes dhe pajtohem më z. Grainca, për uljen vlerave në investime. Propozoi që të shkohet nga vlera maksimale në minimale në $\frac{1}{2}$ për gjysmë nga 30 milionë në 15 milionë euro. Andaj, kuota duhet të zvogëlohet, pasi që Kosova është një treg i vogël, po ta krahasojmë më ndonjë shtet siç është Bullgaria, Kroacia dhe Rumania.

Kryetari tha se deri më tani ka pasur investime në Kosovë dhe më këtë ligj nuk i eliminojmë investimet, por vetëm po i lehtësojmë procedurat. Por ne duhet t'i kemi në target investimet më të fuqishme dhe që i kanë brenda.

Blerim Grainca tha se pajtohet që po lehtësohen procedurat, por më këto vlera që për tregun janë të larta mund të ia mbyllim derën kompanive që mund të investojnë në ndonjë sektor, siç është bujqësia deri në 10 milionë euro.

Sala Berisha – Shala tha se Kosova ka nevojë shumë për investime dhe pajtohemi më koleget parafolës, por propozoi që pragu për investime të ulët në mënyrë që kompania e cila investon të ketë mundësi më të madhe në punësim. Kërkoj që të sektorit të turizmit t’i shtohen edhe parqet rekreative.

Raif Qela tha se po e shoh se kemi dy qëndrime, ka dilema të vlera e investimeve. Propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, deri në harmonizimin e qëndrimeve.

Sasha Milosavljeviq kërkoi sqarime se a janë përfshirë propozimet e tij në amendamentet që i ka propozuar për përfshirjen e komunave në vendimarrje. Dhe, në fund tha se nuk do ta votojë as projektligjin e as amendamentet.

Kryetari tha se sa i përket kësaj çështje ne, grupin punues, i kemi analizuar amendamentet e propozuara nga ana e juaj, por komunat aty caktohet vendi për investitorë strategjikë, marrin pjesë në Komisionin ndërministror. Pastaj, në cilësinë e kryesuesit të grupit punues, e prezantoi dhe e arsyetoi secilin amendament veç e veç, dhe e hodhi në diskutim e votim si vijon:

Amendamenti 1, neni 1, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2, neni 2, ndryshohet.

Kryetari propozoi, që projekti investues strategjik të shtohet edhe sektori për “Transport dhe Telekomunikacion” dhe investimet duhet të jenë së paku tridhjetë milionë euro.

Komisioni përkrahu amendamentin 2 më propozimin e kryetarit.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 3, neni 3, pas nënparagrafit 1.2 shtohet paragrafi i ri.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 4, neni 3, nënparagrafi 1.3 pas emërimit fshihet fjala “nënkupton” dhe kjo vlen për tërë nenin 3.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 5, neni 3, nënparagrafi 1.7. ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 6, neni 3, nënparagrafi 1.10.1 pas fjalës “shumë” shtohet fjala “komuna,”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 7, neni 4 fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 8

Kryetari propozoi që paragrafët 6 dhe 7, në amendamentin 8 të fshihen dhe të mbesin ashtu siç janë në Projektligj.

Komisioni përkrahu amendamentin 8 më propozimin e kryetarit.

Amendamenti 9, neni 6, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 10, neni 7, pas nënparagrafit 2.7 i shtohen edhe dy nënparagraf.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 11, neni 7, pas paragrafit 4, shtohet edhe një paragraf.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 12, neni 8, nënparagrafi 1.3 riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 13, neni 8, nënparagrafi 1.6 riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 14, neni 8, paragrafi 2, fjalia “Agjencisë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve” zëvendësohet me “Komisioni”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 15, neni 8, paragrafi 5 fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 16, neni 8, nënparagrafi 1.6, fjalia “Qeverisë së Republikës së Kosovës” zëvendësohet me “Komisionit”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 17, neni 8, nënparagrafi 1.7 fshihet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 18, neni 10 riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 19, pas nenit 10, shtohet një nen i ri.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni

Amendamenti 20, neni 11, paragrafi 1, në vend “30 ditë pune”, ndryshohet në “20 (njëzet) ditë pune”, dhe në paragrafin 2, “30 ditor”, ndryshohet në “10 (dhjetë) ditor”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni

Amendamenti, 21 neni 12, nënparagrafi 1.6 fjala “investimet e huaja” zëvendësohet me “investimet strategjike”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 22, neni 13, ndryshohet.

Blerim Grainca propozoi që për nenin 13 të çështja padisë të lihet mundësia që t’i drejtohet dhe në gjykatën ndërkombëtare.

Besim Tafa, përfaqësuesi nga Ministra Tregtisë dhe Industrisë, sqaroi se kjo çështje mund të rregullohet në gjykata të Kosovës, ndërsa Ligji për investimet e huaja e rregullon këtë aspektin me Gjykatën Ndërkombëtare.

Pas debatit, amendamenti i grupit punues u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 23, neni 14, pas paragrafit 1, shtohet një paragraf.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 24, neni 15, i ndryshohet titulli si vijon ”Prioriteti i procedurave për investimet strategjike”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni

Amendamenti 25, neni 15, paragrafi 2, pas fjalës “bashkëpunojnë” shtohet fjala “me Grupin operacional”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 26, neni 15, pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3..

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 27, neni 16, paragrafi 2, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 28, neni 16, paragrafi 3, fjalia “30 ditëve” zëvendësohet me “15(pesëmbëdhjetë) ditë”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 29, neni 16, paragrafi 4, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 30, neni 18, ndryshohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 31, neni 20, paragrafi 1, fjala “mund” zëvendësohet me “duhet”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 32, neni 22, ndryshohet si vijon:

Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme për investime strategjike në bazë të Ligjit për shpronësimin të pronës së paluajtshme, vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të marrë vendim me shumicë të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Fatmir Rexhepi, për amendamentin 32 nenit 22, propozoi të marrë vendim me shumicë të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Për shpronësimin të pronës së paluajtshme: të thuhet më 61 votat e 120 deputetëve.

Duda Balje kërkoi që amendamenti të mbetet me shumicën e të gjithë deputetëve të Kuvendit të pranishëm në seance plenare, e jo me 61, pasi që është vështirë për të kaluar dhe për t’ u marrë vendimi për shpronësimin të pronës së paluajtshme.

Pas debatit Komisioni përkrahu amendamentin 32 me propozimin e z. Fatmir Rexhepi.

Amendamenti 33, neni 24, paragrafi 1, fjalia “40 (dyzet) vjet.” zëvendësohet me „deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet“.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 34, neni 26, paragrafi 2, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 34, neni 27, paragrafi 2, viti “2018” zëvendësohet me “2020”.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Amendamentet e Projektligjit Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës.

2. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës për lexim të dytë.

Kryetari dha pauzë në orën 12:40 për të vazhduar në orën 13:00.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, e filloi vazhdimin e mbledhjes, por tha që nuk e kemi kuorumin e mjaftueshëm për mbledhje, kështu që e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa